



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I TIRANËS
FAKULTETI I DREJTËSISË
DEKANATI**



Rruga "Milito TUTULANI", Tiranë, Shqipëri, Tel/Fax. + 355 4 243 1116, <http://www.fdut.edu.al>

Njoftim

Dekanati i Fakultetit të Drejtësisë UT, në mbledhjen e tij të datës 10.01.2019 mori në analizë situatën e krijuar në ambjentet e Fakultetit të Drejtësisë, ku një grup studentësh ka bllokuar ambjentet e fakultetit në pjesën ku zhvillohet procesi mësimor.

E shikojmë me shqetësim të thellë këtë veprim dhe bllokim të institucionit, që bën të pamundur ofrimin e mësimin për studentët që e kërkojnë atë, të cilët nga data 07.01.2019, dita e parë e rifillimit të mësimin, janë shtuar ndjeshëm në ndjekje të procesit mësimor.

Nga ana e studentëve që kanë bllokuar ambjentet e fakultetit nuk është bërë asnjë komunikim apo kërkesë paraprake dhe nuk na është dhënë shpjegim në lidhje me bllokimin e institucionit.

Dekanati i Fakultetit të Drejtësisë është në detyrë dhe është i gatshëm të komunikojë në çdo moment me studentët. Gjithashtu, stafi akademik dhe ai administrative janë në detyrë për të ofruar mësimdhënie dhe shërbime për studentët.

Dekanati

Fakultetit të Drejtësisë